



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 91 Nr. i faq./Br.str./No.pg 9/13

Data/Datum/Diti 27.06.2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1 pika 1.3, dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2022 miraton këtë:

### V E N D I M

#### Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510063-00364-0 në Zonën Kadastrale Polluzhë

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/726/23, i datës 8.6.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510063-00364-0 në Zonën Kadastrale Polluzhë, në sipërfaqe prej 210m<sup>2</sup> (dyqind e dhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 610m<sup>2</sup> (gjashtëqind e dhjetë metra katror) në vendin e quajtur Sarash, me kulturë livadh i klsasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Ibrahim (Zeqë) Hoti.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.91/23  
Datë:27.06.2023

